



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



**KOMUNA E GJAKOVËS**

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

**01 Nr. DM/A1-29634 /2022**

**Datë: 26.10.2022**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2022 pas diskutimit në pikën e 3 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për ndryshimin e vendimit 01 nr.011-49415 të datës 25.11.2016 , e miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 , për shfrytëzimin e banesave kolektive në pronësi komunale për Banim Social.
2. Nga pika e 1 e vendimit 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 për shfrytëzimin e banesave Kolektive për Banim Social , largohet ndërtesa në parcelën 4501-38-80-0 e destinuar për banim Social .
3. Pjesa tjetër e vendimit 01 nr.011-49415 i datës 25.11.2016 për shfrytëzimin e banesave Kolektive për Banim Social mbetet në fuqi, dhe e pa ndryshuar .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
  - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
  - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit.



Arbënësna Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	26.10.2022 <u>01-011/01-24181</u>
Për:	Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim - vendim për ndryshimin e vendimit për shfrytëzimin e banesave kolektive në pronës të Komunës për banim social - 01-011-49415



Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41 shkronja (a) dhe (h) të Statutit të Komunës së Gjakovës, si dhe nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

### PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miraton vendimin për ndryshimin e pikës 1 të vendimit 01Nr.011/49415 të datës 02.12.2016, për shfrytëzimin e banesave kolektive të pronës së Komunës për banim social.
2. Nga pika 1 e vendimit për shfrytëzimin e banesave kolektive të pronës së Komunës për banim social, largohet parcela 4501-38-80-0, e destinuar për banim social.
3. Pjesa tjetër e vendimit 01Nr.011/49415 të datës 02.10.2016, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale mbetet e pandryshuar.

Me respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVAP1 011-49 915  
P2 12 2016

## Kuvendi i Komunës – Gjakovë

01,nr. \_\_\_\_\_ /2016

Dt. 25.11.2016

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenit 12 dhe 17 pika (k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.11.2016, pas diskutimit lidhur me pikën e 5-të, të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetares së Komunës për destinimin e shfrytëzimit të njësive banesore nga banimi Kolektiv në banim Social, e miratoi këtë:

## V E N D I M

## Për shfrytëzimin e banesave kolektive në pronësi të Komunës për banim Social

1. Ndërtesat kolektive me njësi banimi që janë në pronësi të Komunës së Gjakovës e që evidentohen me certifikatë pronësore nr. 4501-38-80-0. Ndërtesa me certifikatë pronësore nr. 4501-244-0, P+5. Ndërtesa me certifikatë pronësore nr. 4501-2-79-0, P+3 rr. "Tirana" zona kadastrale Jashtë-Qytet si dhe Ndërtesa me njësi banimi e njohur si ndërtesa e "Dibranëve" e evidentuar me certifikatë pronësore nr. 5767-0-122-0 zona kadastrale Gjakovë-Qytet të destinohen në ndërtesa për banim social për qytetaret e Komunës së Gjakovës.
2. Ndërtesat e përshkruara në pikën e parë të këtij Vendimi do të shfrytëzohen me qëllim të zgjidhjes së çështjes së strehimit për rastet sociale në Komunën e Gjakovës.
3. Procedura për dhënien e pronave të paluajshme - Ndërtesave me njësi të banimit për banim social, Komuna e Gjakovës do t'i jep në shfrytëzim në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit Nr.03/L-164, Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit si dhe Udhëzimit Nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçantë të banimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës .
5. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetares së Komunës,
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
  - Drejtoria për Shërbime Publike
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës,
  - Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Luan Gola